



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

## AVOKATI I POPULLIT

### RAPORT ME REKOMANDIME

I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

përkitazi me

vizitën në QENDRËN E MBAJTJES PËR TË HUAJT NË VRANIDOLL

**Për** Z. Bejtush Gashi, Ministër  
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Valon Krasniqi, Drejtor  
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

Z. Kushtrim Haliti, Drejtor  
Qendra e Mbjajtjes për të Huaj

**Kopje** Duda Balje, Kryetare  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi |Gjinore, për Persona të  
Pagjetur dhe Peticione

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt në Vranidoll.

Prishtinë, 2 maj 2018

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit sipas nenit 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë këtu edhe vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës.

Bazuar në këtë mandat, MKPT më 7 mars 2018 e ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (në tekstin e mëtejshëm “QMH”). Qendra e Mbajtjes për të Huajt funksionin në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejshëm “Rregullorja”), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye tjera. Qendra ka filluar punën në vitin 2010. Kapaciteti i kësaj Qendre është 76 persona.

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të të huajve të cilët mbahen në QMH të cilat parashihen me Ligjin për të Huajt, Ligjin për Azil, Rregulloren për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt dhe standardet ndërkombëtare. Ekipi monitorues përbëhej nga një këshilltar ligjor, një mjek dhe një psikologe.

Gjatë vizitës, në veçanti janë trajtuar çështja e procedurave të pranimit, njohja e të huajve me të drejtat e tyre, trajtimi dhe akomodimi, kujdesi shëndetësor i cili u ofrohet, kontaktet e mirëfillta me botën e jashtme, personeli i QMH dhe personeli i sigurisë, trajnimet dhe përgatitja adekuate e tyre për të punuar me këtë kategori, masat disiplinore të cilat mund t’u shqiptohen të huajve në QMH dhe mënyra e ekzekutimit të tyre, e drejta për të ankimuar masën e tillë dhe aspekte të tjera.

Gjatë vizitës në QMH, personeli i Qendrës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipi i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësua intervistimi i personave që gjendeshin në mbajtje pa prezencë të zyrtarëve të sigurimit dhe zyrtarëve tjerë të QMH.

Bazuar në të gjeturat gjatë kësaj vizite, MKPT e Avokatit të Popullit, autoriteteve kompetente u ka rekomanduar të ndërmarrin veprimet në kuadër të kompetencave të tyre në mënyrë që respektimi i të drejtave të të huajve në QMH të jetë në pajtim me ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare, veçanërisht standardet e përcaktuara nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës të publikuara në mars të vitit 2017.

### Procedurat e pranimit

1. Neni 7 i Rregullores përcakton se pranimi në Qendër bëhet bazuar në urdhrin për ndalimin e të huajit në Qendër i cili nxirret nga DMH. Me rastin e dorëzimit të të huajit në Qendër, DMH duhet të dorëzojë: urdhrin për ndalim në Qendër, urdhrin për largim me forcë, si dhe urdhri për largim vullnetar nëse është nxjerrë, raportin e zyrtarit policor duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikshmërisë, vërtetimin për dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara, si dhe dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara. Më tej, sipas Rregullores Qendra e konfirmon

pranimin e të huajt në Qendër përmes fletëpranimit<sup>1</sup>. Bazuar në dosjet e të huajve prezent, MKPT ka vërejtur se nga autoritetet janë respektuar kriteret e lartpërmendura të përcaktuara në Rregullore.

### Garancitë kundër keqtrajtimit

2. MKPT vëren se standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “KPT”) përcaktojnë shprehimisht se të gjithë të huajt e paraburgosur si emigrantë të parregullt që nga momenti i privimit nga liria duhet të gëzojnë tri të drejta themelore në të njëjtën mënyrë siç i gëzojnë edhe kategoritë tjera të personave të privuar nga liria. Këto të drejta janë: të kenë qasje tek avokati mbrojtës, të kenë qasje tek një mjek dhe të kenë mundësinë të njoftojnë të afërmit e tyre apo palën e tretë sipas përzgjedhjes së tyre për faktin se janë paraburgosur.<sup>2</sup>
3. Po ashtu, MKPT vëren se KPT, në raportin për vizitën në Holandë në vitin 2007, në paragrafin 36, shprehimisht përcakton:

*“Sipas pikëpamjes së Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, të huajt e paraburgosur për shkak të emigracionit (qofshin ata azilkërkues ose jo) duhet të kenë të drejtën që që nga momenti i privimit të tyre nga liria të informojnë personin sipas përzgjedhjes së tyre për situatën e tyre, të kenë qasje tek mjeku dhe avokati. Më tej, të huajt e paraburgosur për shkak të imigracionit duhet të njoftohen shprehimisht, pa vonesa dhe në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe procedurën e cila zbatohet në rastin e tyre. Për këtë qëllim, të paraburgosurve për shkak të imigracionit duhet në mënyrë sistematike t’u ofrohet dokumenti i cili përmban këtë informacion; dokumenti duhet të jetë në dispozicion në gjuhët më të shpeshta të folura nga personat në fjalë dhe nëse është e domosdoshme duhet të jenë në dispozicion shërbimet e përkthyesit. Personat në fjalë (të paraburgosurit) duhet të vërtetojnë se ata janë njoftuar për të drejtat e tyre në gjuhën të cilën ata mund ta kuptojnë”.*<sup>3</sup>

4. Bazuar në dispozitat e Ligjit 04/L-219 për të Huajt të Republikës së Kosovës, i huaji i cili vendoset në Qendër njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendrën e Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet”.<sup>4</sup>
5. Sa i përket të drejtës së të huajt për të kontaktuar konsullatën apo ambasadën e shtetit, MKPT vëren se Ligji për të Huajt përcakton të drejtën e të huajt për të njoftuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor lidhur me ndalimin e tij.<sup>5</sup> Po ashtu, KPT në Raportin e 19-të Përgjithshëm, të drejtën e të paraburgosurit të huaj për të kontaktuar konsullatën e vendit nga i cili janë e konsideron si një të drejtë themelore.<sup>6</sup>

<sup>1</sup> Neni 7 i Rregullores për Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

<sup>2</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 19-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 81, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22%5D%7D>, (14.3.2018)

<sup>3</sup> Shih në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-nld-20070607-en-14%22%5D%7D>, (14.3.2018).

<sup>4</sup> Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 108.

<sup>5</sup> Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 114, paragrafi 3.

<sup>6</sup> Për më shumë shih në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22%5D%7D>, (14.3.2018)

6. Sipas Rregullores dhe Ligjit për të Huajt, i huaji i vendosur në këtë Qendër ka të drejtat në vijim: informimi lidhur me të drejtën e ankimit për ndalimin në Qendër, të drejtën lidhur me ndihmën juridike falas, të drejtën për përkthyesin në gjuhën e tij ose në një gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, të drejtën për të komunikuar me organet dhe organizatat relevante vendore apo ndërkombëtare, si dhe me organizatat jo-qeveritare.<sup>7</sup>
7. MKPT ka vërejtur se në të gjitha korridoret e Qendrës operojnë kamerat e sigurisë të cilat janë vazhdimisht operacionale. Sipas njoftimit të zyrtarëve, imazhet e kamerave të sigurisë ruhen deri në dy muaj. Në raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2010, KPT konsideroi ekzistimin e kamerave të sigurisë si një nga garancitë kundër keqtrajtimit fizik në qendrat ku mbahen personat e privuar nga liria.<sup>8</sup>
8. Sa i përket të drejtës për t'u informuar në gjuhën e tyre apo në gjuhën të cilën të huajt e paraburgosur e kuptojnë dhe të drejtës për të pasur shërbime të një përkthyesi, MKPT është njoftuar nga Qendra se MPB posedon listën e përkthyesve të cilët ofrojnë shërbime përkthimi edhe në gjuhët tjera të të huajve përveç shërbimeve në gjuhën angleze.
9. **MKPT, gjatë vizitës ka vërejtur se të huajt në QMH informohen për të drejtat e tyre përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të shpeshta, por QMH nuk posedon një dokument në të cilin këto të drejta janë të shkruara dhe në të cilin të huajt e paraburgosur vërtetojnë se ata janë njoftuar me të drejtat e tyre në gjuhën të cilën ata e kuptojnë.**

#### **Keqtrajtimi**

10. Gjatë vizitës së MKPT-së, në Qendër ishin prezent 5 persona të huaj të ndaluar. MKPT ka kontrolluar dosjet e tyre si dhe realizoi intervista në dhomat ku ishin të akomoduar pa prezencë të zyrtarëve të QMH dhe personelit të sigurimit. MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH e cila nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre.

#### **Incidenti i datës 19 janar 2018**

11. Gjatë kontrollit të regjistrave dhe dosjeve të personave të akomoduar në këtë qendër, MKPT ka vërejtur se më 19 janar 2018, njëri nga personat e huaj të ndaluar e kishte thyer xhamin me grusht dhe si pasojë, e kishte lënduar dorën.
12. MKPT intervistoi personin në fjalë dhe nuk pranoi ankesa lidhur me trajtimin e tij nga ana e personelit të QMH dhe personelit të sigurisë. Në dosjen e tij u verifikua se personi e kishte marrë ndihmën mjekësore me kohë.
13. MKPT më 8 mars 2018, përmes postës elektronike ka kërkuar nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, që ti mundësohet MKPT-së qasja në kamerat e sigurisë, në mënyrë që të shikohen imazhet e datës 19 janar 2018 të cilat ndërlidhen me incidentin në fjalë.

<sup>7</sup> Neni 9 i Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funkcionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>, (13.3.2018)

<sup>8</sup> Raporti i KPT për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18, publikuar në vitin 2011, në: <https://rm.coe.int/1680696c98>, (15.3.2018).

14. Gjatë takimit me DSHAM, MKPT u njoftua se do të konsultohet Departamenti për Teknologji Informative lidhur me qasjen në kamerat e sigurisë dhe nëse ekziston mundësia teknike të këto video të ruhen më gjatë. **MKPT do të monitorojë këtë çështje edhe në të ardhmen.**

#### **Ndihma juridike falas**

15. Sipas zyrtarëve të QMH, UNHCR u ofron ndihmë juridike falas vetëm të huajve në mbajtje të cilët janë azilkërkues potencial, por jo edhe të tjerëve. Po ashtu, rregullorja në fuqi u ofron qasje në çdo kohë Avokatit të Popullit dhe disa organizatave tjera relevante ndërkombëtare. Nga dokumentet e kontrolluara MKPT ka vërejtur se në QMH kanë qasje edhe organizatat vendore jo-qeveritare.
16. Gjatë takimit me drejtorinë e DSHAM më 23 mars 2018, MKPT u njoftua se një opion për të ofruar ndihmë juridike falas është Agjencia Shtetërore për Ndihmë Juridike Falas. Por sipas përgjegjësitë të QMH, kohëve të fundit kjo agjenci nuk vjen në QMH. Më 26 mars 2018, MKPT ka komunikuar me OJQ CRPK e cila e njoftoi se të huajve në QMH u ofron ndihmë juridike falas vetëm nëse të paraburgosurit e huaj janë kandidatë potencial për të kërkuar azil politik, ndryshe jo.
17. Më 28 mars 2018, MKPT kontaktoi me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për të verifikuar nëse kjo agjenci është e involvuar në ofrimin e ndihmës juridike për të huajt e paraburgosur të cilët janë subjekt i kthimit me forcë. Sipas zyrtarëve të agjencisë, agjencia sipas Ligjit për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas mund t'u ofrojë ndihmë juridike falas të huajve të cilën kanë leje qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës, por deri më tani nuk kanë pasur raste të ofrimit të ndihmës juridike për të paraburgosurit e huaj.
18. **MKPT vëren se neni 9 paragrafi 1.2 i Rregullores parasheh të drejtën për ndihmë juridike falas për të huajt të cilët gjenden në mbajtje në QMH.**
19. Më tej, sipas kësaj Rregulloreje, me rastin e pranimit të të huajit në Qendër, zyrtari i Qendrës e informon të huajin për rregullat e QMH. Qendra duhet të sigurojë broshurat informative në gjuhë të huaja për të drejtat dhe detyrimet e të huajit i cili vendoset në Qendër. **MKPT, ka vërejtur se Qendra posedon broshura në gjuhë të ndryshme, siç janë: arabe, frënge, turke, angleze, me qëllim të njoftimit të të huajve për të drejtat e tyre.**

#### **Kushtet materiale**

20. Gjatë vizitës në Qendër, MKPT ka vizituar dy objektet ku mbahen të huajt, përfshirë të gjitha hapësirat siç janë dhomat e intervistimit, dhomat e izolimit, dhomat e fjetjes, dhomat familjare, dhomat e aktiviteteve për të rritur, të cila ishin të pajisura me TV, letra, tabelë shahu, si dhe në një kënd ishte biblioteka me një numër të vogël të librave, dhoma e aktiviteteve për fëmijë të pajisur me lodra dhe të dizajnuar sipas standardeve, dhomën ku ju mundësohej kryerja e aktiviteteve fetare, kuzhinën e cila ishte e kompletuar me orëndi, si dhe një lavanteri të pajisur mjaftueshëm për kapacitetin e Qendrës. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje dhe ndriçim të mjaftueshëm natyral. **MKPT konsideron se Qendra i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të personave të huaj.**

21. Gjatë vizitës MKPT u njoftua se QMH nuk furnizohej me ujë për shkak të defekteve teknike si pasojë e vërshimeve. MKPT u njoftua se Qendra kishte mungesë të ujit gati 5 ditë. MKPT ka vërejtur se në disa hapësira të QMH kundërmonte erë s, gjithashtu në një pjesë të koridorit vërehej lagështi, për shkak të dëmtimit të gypave. Sipas udhëheqësit të Qendrës, me pak rezerva të ujit janë munduar të menaxhojnë situatën, por të pa mjaftueshme për personat e ndaluar dhe personelin.
22. MKPT menjëherë pas vizitës, kontaktoi me Kompaninë Rajonale të Ujësllësit për t'u informuar lidhur me këtë gjendje. Drejtoria e Ujësllësit premti se do të merr veprime të menjëhershme për të evituar problemet teknike dhe për të furnizuar rregullisht QMH me ujë. Më datë 9 mars 2018, drejtori i QMH e njoftoi MKPT se çështja e ujit është rregulluar. **MKPT çmon lartë angazhimin e menjëhershëm të Kompanisë Rajonale të Ujësllësit, si autoritet kompetent në këtë rast, për të furnizuar QMH me ujë.**

### Regjimi

23. Neni 24, paragrafi 1 i Rregullores përcakton se çdo i huaj i ndaluar në Qendër ka të drejtë në ajrosje së paku dy (2) orë në ditë në mjediset e jashtme të Qendrës. Për arsye shëndetësore udhëheqësi i qendrës mund të zgjasë kohën e ajrimit. Më tej neni 24 paragrafi 3 përcakton se gjatë kohës së ajrimit mund të zhvillohen aktivitete kulturore dhe sportive.
24. MKPT ka vërejtur se Qendra ka një fushë të vogël sportive e cila nuk është e pajisur me elementet përcjellëse ku të huajt do të mund të merreshin me aktivitete konkrete sportive, siç janë basketbolli, futbollit dhe lojëra të tjera sportive. **MKPT, ashtu si edhe në raportin me rekomandime të publikuar pas vizitës në QMH në vitin 2016, inkurajon autoritetet relevante të shtojnë përpjekjet e tyre për ofruar mundësitë për aktivitete konkrete sportive dhe aktivitete të tjera për të huajt në këtë Qendër.**
25. KPT, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi i cili përmban sa më shumë aktivitete. **Sipas KPT, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet të cilat u ofrohen atyre.**<sup>9</sup>
26. Gjatë takimit me drejtorin e DSHAM, MKPT u njoftua se janë hapur procedurat tenderuese për furnizim me pajisje përcjellëse në mënyrë që të huajve të paraburgosur në QMH t'u ofrohen më shumë aktivitete.

### Personeli i Qendrës së Mbajtjes për të Huajt

27. Personeli i Qendrës përbëhet nga udhëheqësi, dy zyrtarë për pranim dhe regjistrim të të huajve dhe personeli i sigurimit. Gjatë vizitës, MKPT u informua se personeli i sigurimit është i trajnuar për të kryer detyra të mbrojtës fizike të objektit dhe pronës, por nuk janë të trajnuar për të punuar me persona të huaj të privuar lirie të cilët sipas Ligjit për të Huajt janë subjekt i kthimit me forcë. **Lidhur me këtë, MKPT më 23 mars 2018 zhvilloi takim zyrtar me drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion me ç' rast u njoftua se personeli i sigurisë nuk kanë kryer trajnime adekuate për të punuar me këtë kategori.**

<sup>9</sup> Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>, (14.3.2018)

28. Lidhur me personelin e nevojshëm në qendra të tilla, MKPT vëren se KPT në standardet e publikuara në mars të vitit 2017 për qendrat e mbajtjes për të huajt veçanërisht thekson se personeli mbikëqyrës në këto qendra duhet të përzgjidhet me kujdes dhe të trajnohet në mënyrë të përshtatshme.
29. Krahas zotërimit të cilësive të zhvilluara në fushën e komunikimit ndër-personal, personeli në fjalë duhet të familjarizohet me kulturat e ndryshme të të ndaluarve dhe të paktën disa prej tyre të kenë aftësitë gjuhësore përkatëse. Më tej, ata duhet të dallojnë simptomat e mundshme të reagimit ndaj stresit që shfaqen nga personat e ndaluar dhe të marrin masat e përshtatshme.
30. Po ashtu, KPT thekson se karakteri i një institucioni të paraburgimit për të huajt për shkak të imigrimit nuk duhet të jetë i tipit të burgut, që do të thotë se personeli i cili punon në qendrën e mbajtjes për të huajt nuk duhet të jetë i pajisur me shufra gome, pranga apo *pepper spray* dhe ka rekomanduar që pajisjet e tilla të mos barten në atë mënyrë që të shihen haptazi nga të huajt.<sup>10</sup>
31. Sipas zyrtarëve të QMH, personeli i sigurisë në QMH, në kuadër të pajisjeve të tyre kanë pranga dhe shufra gome. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se personeli i sigurisë i bartë pajisjet të cilat i ka në dispozicion në atë mënyrë që ato nuk mund të shihen haptazi nga të huajt e paraburgosur.

#### **Kujdesi shëndetësorë**

32. Standardet e përcaktuara nga KPT lidhur me të drejtat e të ndaluarit të huaj përcaktojnë të drejtën për të pasur shërbimet mjekësore si e drejtë themelore dhe një nga garancitë kundër keqtrajtimit.
33. Neni 10 i Rregullores (Ekzaminimi mjekësor) shprehimisht përcakton se personeli profesional mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësorë të të huajve pas vendosjes së tyre në këtë qendër. **Rregullorja më tej parasheh se të gjithë të huajve të moshës mbi pesë vjeçare duhet tu bëhet testi i tuberkulozes dhe në kuadër të kësaj duhet tu bëhet rëntgeni i mushkërive.**
34. Sipas përgjegjësitë të QMH, të huajve u bëhen këto ekzaminime në pajtim me Rregulloren, përveç rasteve të caktuara të cilat depërtohen menjëherë. Po ashtu, ekzaminimet paraprake bëhen edhe nga Policia e Kosovës, para se të huajt të sjellën në QMH.
35. **Megjithatë, nga dosjet e kontrolluara të të huajve të cilët ishin në mbajtje në QMH, MKPT nuk hasi në fakte që dëshmojnë se është vepruar në pajtim me nenin 10 të Rregullores.**
36. Lidhur me të huajt me aftësi të kufizuara mendore të cilët manifestojnë simptoma të çrregullimeve mendore, Rregullorja parasheh se duhet të sigurohet trajtimi psikologjik dhe këshillim profesional mjekësor. Sipas rregullores, këto shërbime mund të ofrohen nga Organizatat Jo-Qeveritare relevante në bazë të kërkesës nga i huaji.

<sup>10</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Të ndaluarit për shkak të imigracionit, standardet e publikuara në vitin 2017, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>, (15.3.2018)

37. MKPT u njoftua se shërbimet mjekësore të huajve në këtë qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe Qendra Klinike Universitare.
38. Po ashtu, Më 23 mars 2018, MKPT zhvilloi takim zyrtar me drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion i cili e njoftoi se Organizata Jo Qeveritare e cila më herët ofronte shërbime psikologjike falas, tani e ka ndërprerë këtë shërbim.

#### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore në QMH me rastin e pranimit**

39. KPT<sup>11</sup> thekson se çdo pranim i ri në këtë Qendër të mbajtjes, duhet të përfitojë nga një mundësi e ekzaminimit gjithëpërfshirës mjekësorë (duke përfshirë sëmundjet transmetuese) nga një mjekë ose një infermier të kualifikuar, e cila i raporton një mjeku të kualifikuar sa më shpejt që është e mundur, pas pranimit të personave të huaj.
40. Për më shumë, KPT në raportet për shtete dhe raportet e përgjithshme, vazhdimisht ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore sidomos në rastet e të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.<sup>12</sup>
41. MKPT gjatë vizitës së fundit më 7 mars 2018, u njoftua se të huajve të sapo pranuar në këtë Qendër nuk u bëhen ekzaminime të përgjithshme mjekësore, përveç nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë, edhe pse kjo shprehimisht parashihet në nenin 10 të Rregullores. Në rastet kur personi i huaj gjatë qëndrimit në Qendër ka nevojë për mjek, zyrtari i Qendrës e thëret Emergjencën për të ofruar shërbimin mjekësor. **Në rastet kur personit të huaj i caktohet terapi me medikamente, terapia i jepet nga zyrtarët jo kompetent (personeli i sigurisë dhe zyrtarët tjerë) pasi që nuk ka staf mjekësor brenda Qendrës.**
42. MKPT ka vërejtur se të gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të huajit mbahen në dosjen e tij/saj personale. Në dosjen e tij/saj personale kanë qasje zyrtarët e Qendrës. KPT<sup>13</sup> thekson se **konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në të njëjtën mënyrë si në komunitet, në veçanti dosjet mjekësore nuk duhet të jenë të qasshme për personelin jo mjekësorë, por duhet të mbahen të mbyllura nga infermierja ose mjeku.**
43. Prandaj, MKPT konsideron se QMH duhet të ketë së paku një infermiere të kualifikuar, e cila do të kryej shqyrtimin fillestar mjekësor të të sapo pranuarve, të pranojë kërkesat e nevojshme për vizitë nga mjeku, të shpërndaj terapin, të mbikqyr dosjet mjekësore, dhe të mbikëqyrë kushtet e përgjithshme të higjienës. Personave të huaj të paraburgosur gjithashtu duhet të ju ofrohet asistencë psikologjike dhe kujdes psikiatrik në rast nevojë.

<sup>11</sup> KPT, Të ndaluarit për shkak të Migracionit [ CPT/Inf(2017)3 ], paragrafi 9, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12> (13.3.2018)

<sup>12</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62, në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>, (6.3.2018). Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti i 26-të i përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>, (6.3.2018).

<sup>13</sup> KPT, Të Ndaluarit për shkak të Migracionit [ CPT/Inf(2017)3 ], shih linkun <http://hudoc.cpt.coe.int/eng?i=p-standards-inf-2009-27-part-en-5>, (13.3.2018)

## Masat disiplinore dhe mjetet e kufizimit

44. Rregullorja përcakton se në rastet kur i huaji me sjelljen e tij përbën rrezik për veten, për të huajt tjerë në qendër, personelin e Qendrës, personat e tretë, sigurinë dhe rendin, si dhe të mirat materiale të Qendrës, mund të ndërmerren masat si në vijim: përdorimi i forcës fizike e cila duhet të jetë proporcionale dhe e ligjshme. Kjo masë është masa e fundit e cila përdoret vetëm nëse dështojnë masat tjera. **Po ashtu, Rregullorja parasheh se në kuadër të këtyre masave mund të bëhet edhe prangosja e duarve dhe këmbëve.**<sup>14</sup>
45. Sipas Rregullores, masat disiplinore të cilat mund t'i shqiptohen të huajit janë: vërejtja me gojë apo me shkrim, detyrimi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Qendrës, heqja e të drejtës për aktivitete të lira, rekreacion, TV, internet, heqja e të drejtës për aktivitete kulturore dhe sportive në kohëzgjatje deri në 5 ditë dhe izolimi deri në 48 orë.
46. Gjatë kontrollit të regjistrave dhe dosjeve të personave të akomoduar në këtë qendër, MKPT ka vërejtur se më 19 janar 2018, njëri nga personat e huaj të ndaluar, duke tentuar që të thyej xhamin, kishte pësuar lëndim. **Për shkeljen disiplinore shkatërrimi ose prishja e qëllimshme e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të Qendrës, Udhëheqësi i Qendrës, ia shqiptoi personit në fjalë masën disiplinore të veçimit për 48 orë.**<sup>15</sup> MKPT vëren se Rregullorja nuk përmban dispozita të cilat e obligojnë QMH që të tuajit në mbajtje t'ia dorëzojë kopjen e vendimit për masë disiplinore të vetmisë, por vetëm parasheh se vendimi duhet t'i bashkëngjitet dosjes së të huajit.
47. Në raportin për vizitën në Ukrainë në vitin 2009, KPT, **u rekomandoi autoriteteve Ukrainase që të huajit të cilit i shqiptohet masa disiplinore e veçimit t'ia dorëzojnë një kopje të vendimit relevant dhe ta informojnë për mundësinë për ta apeluar vendimin në fjalë tek një autoritet i jashtëm, t'u garantojnë të huajve të cilëve u shqiptohet kjo masë qasje të rregullt në dush dhe që të rishqyrtojnë regjimin e ofruar për të huajt të cilëve u shqiptohet kjo masë disiplinore.** Sipas KPT, në veçanti duhet të ndërmerren hapa për të siguruar se ata kanë qasje në oborrin i cili është i pajisur në mënyrë adekuate për ajrosje së paku një orë në ditë, si dhe të kenë qasje në materiale për lexim.<sup>16</sup>
48. MKPT konsideron se në Rregullore duhet të bëhen ndryshime në pajtim me rekomandimet e Komitetit Evropian për vizitën në Ukrainë, Bullgari dhe Francë, respektivisht të theksohet shprehimisht në Rregullore se të huajit të cilit i shqiptohet masa disiplinore duhet t'ia dorëzohet një kopje e vendimit të udhëheqësit të QMH ose zyrtarit të autorizuar për të shqiptuar një masë të tillë në gjuhën të cilën ai e kupton ose në gjuhën angleze.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Neni 46 i Rregullores për Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

<sup>15</sup> Neni 47 i Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funkcionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve.

<sup>16</sup> Shih në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-ukr-20090909-en-17%22%7D%7D>, (14.3.2018).

<sup>17</sup> Për më shumë, shih Raportin e 19-të të përgjithshëm të KPT, paragrafi 88, në:

<http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-4%22%7D%7D>, Raportin e KPT për vizitën në Ukrainë në vitin 2009, paragrafi 71, në:

<http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-ukr-20090909-en-17%22%7D%7D>, Raportin e KPT për vizitën në Bullgari, në vitin 2008, paragrafi 44, në:

<http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-bgr-20081215-en-12%22%7D%7D>, Raportin e KPT për vizitën në Francë në vitin 2006, paragrafi 76, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-fra-20060927-fr-14%22%7D%7D>, (14.3.2018)

49. KPT<sup>18</sup> thekson se është në interes të personave të huaj të ndaluar dhe të stafit që të kenë të shkruar rendin shtëpiak në të gjitha ambientet e Qendrës dhe kopjet duhet të vihen në dispozicion në një gjuhë të përshtatshme. Rendi shtëpiak duhet të trajtojë një gamë të gjerë të çështjeve, të drejtave dhe detyrave që lidhen me rutinën ditore. Rregullat e shtëpisë duhet përfshirë edhe procedurat disiplinore dhe t'u sigurojnë personave të ndaluar të drejtën për tu dëgjuar në lidhje me shkeljen që pretendohet se e kanë kryer dhe për mundësin për të apeluar tek një autoritet tjetër i pavarur kundër çdo sanksioni të vendosur. Pa rregulla të tilla, ekziston rreziku që sistemi disiplinor jozyrtar (dhe i pa kontrolluar) të zhvillohet. **MKPT gjatë vizitës, ka vërejtur se përveç broshurave informuese, nuk kishte dokument të veçantë për rendin shtëpiak dhe njohuri për procedurat disiplinore.**

#### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

50. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda Qendrës dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

51. Neni 19 i Rregullores përcakton se huajt kanë të drejtë ankese tek udhëheqësi i Qendrës lidhur më kushtet e pranimit në Qendër dhe sjelljet e personelit. Ankesa dërgohet në DSHAM, brenda 7 ditësh. Më tej Rregullorja përcakton se në Qendër vendoset kutia e ankesave e cila administrohet nga Qendra. Një kuti e ankesave vendoset dhe administrohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit.<sup>19</sup>

52. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të huajve në Qendër është një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra.

#### **Kontakti me botën e jashtme**

53. KPT konsideron se të ndaluarit e huaj duhet të kenë çdo mundësi për të qenë në kontakt të mirëfilltë me botën e jashtme, (përfshirë mundësitë për të bërë telefonata dhe për të pranuar vizita) dhe liria e tyre e lëvizjes brenda qendrës së mbajtjes duhet të duhet të kufizohet sa më pak që kjo të jetë e mundur.<sup>20</sup> Rregullorja përcakton se i huaji në këtë qendër ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera.

54. Po ashtu, Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash duke filluar nga ora 09:00 deri në ora 16:00. Sipas Rregullores të huajve u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Të huajve të vendosur në Qendër u lejohen edhe vizitat. **Gjatë vizitës, MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket të drejtës për kontakte me botën e jashtme.**

<sup>18</sup> [ CPT/Inf(2017)3 ] ; shih në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng?i=p-standards-inf-2009-27-part-en-4> , (13.3.2018)

<sup>19</sup> Neni 19 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores për Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

<sup>20</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>, (14.3.2018).

Prandaj, bazuar në të të gjeturat gjatë vizitës, MKPT i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- QMH duhet të ketë në dispozicion së paku një infermiere e cila do të kryente kontrollet mjekësore të sapo pranuarve, shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH dhe një psikolog siç parashihet në Rregullore.
- Qendra duhet të mbajë protokollat si në vijim: Protokolle për vetminë, për lëndime trupore, vetëlëndime, tentim vetëvrasjes, abuzim seksual dhe të vdekjeve.
- Personeli i sigurisë duhet t'u nënshtrohet trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori.
- Për të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre, të huajt të njoftohen përmes një dokumenti të veçantë, në gjuhën të cilën e kuptojnë dhe në të cilin ata vërtetojnë se i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre.
- Rregullorja të përmbajë një dispozitë të veçantë e cila parasheh se të huajt të cilit i shqiptohet masa disiplinore t'i dorëzohet një kopje e vendimit në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton.
- Të huajve të paraburgosur t'u ofrohet ndihma juridike falas në pajtim me Rregulloren.

  
Me nderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit